



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:243823  
Datë: 16.05.2024  
Numri i dokumentit: 05694032

KE.nr.336/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të paditësit “Adio” Sh.p.k me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Arbër Istrefi me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.A. nga Komuna e Obiliqit, objekt i kontestit kompensim dëmi, vlera e kontestit 3,785.71 euro, jashtë seance me datën 16.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit “Adio” Sh.p.k me seli në Prishtinë e ushtruar më datën 17.03.2014, kundër të Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi, më datën 17.03.2014 në Gjykatën Themelore Prishtinë Departamenti për Çështje Ekonomike ndaj të paditurit Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniqa Group Austria” ka ushtruar padi për kompensimin e dëmit.

Kjo lëndë është transferuar në Gjykatën Komerciale të Kosovës sipas vendimit me numër 347/22 të datës 28.07.2022 të KGJK-së për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.05.2024, nuk ka prezantuar paditësi e as i padituri, për të cilët Gjykata ka dëshmi se të njëjtit ishin ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën për në seancë nuk e kanë arsyetuar në as një formë.

Meqenëse paditësi nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesor, mungesën e tij nuk e ka arsyetuar edhe pse i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, fakt ky i vërtetuar nga procesverbali

i seancës së datës 25.04.2024, në të cilën seancë ka prezantuar i autorizuari i paditësit, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore, gjykata vendosi që të njëjtën ta konsideroj të tërhequr në kuptim të nenit 423 par.3 të LPK-së

Nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 423 par.3 të LPK-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.336/22 me datë 16.05.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.